

VENDIM
Nr. 118, datë 4.4.2023

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ECO-ELB” SHA, PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI I PËRPUNIMIT TË MBETJEVE URBANE, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2850 kw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 44, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5 pika 1, germa “a” dhe 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, i ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 137/5 prot., datë 30.3.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “ECO-ELB” sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, me kapacitet të instaluar 2850 kw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “ECO-ELB” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1843 prot., datë 9.11.2022, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali TEC (përpunimi i mbetjeve urbane), me kapacitet të instaluar 2850 kw.

- Sa konstatuar, aplikimi i shoqërisë është depozituar sipas afatit të përcaktuar në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Sa më sipër, pas përmbushjes së kriterëve formale ligjore, është vlerësuar që në përputhje me përcaktimet e germave “b” dhe “d” të nenit 44, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është njoftuar shoqëria mbi sa konstatuar për kontratën e qirasë.

- Pas korrespondencës së zhvilluar ndërmjet ERE dhe shoqërisë “ECO-ELB” sh.a., në lidhje me statusin e rinovimit të kësaj kontrate, rezulton se me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 137/4 prot., datë 27.3.2023, shoqëria ka depozituar në ERE: Kontratën e rinovuar të qirasë, me nr. 1027 prot., datë 10.3.2023, të nënshkruar mes Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (Qiradhënësi) dhe shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. (Qiramarrësi). Në pikën 4 të kësaj kontrate përcaktohet se ajo lidhet me një afat 1-vjeçar, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës, nga 28.3.2023 deri më datë 27.3.2024, me të drejtë rinovimi.

- Në këto rrethana, vlerësojmë se janë plotësuar të metat e kërkesës dhe veprimet e nevojshme për fillimin e procedurës, në përputhje edhe me përcaktimet e nenit 44 të KPA-së.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e kërkuar nga neni 16, formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur); si dhe të ketë kryer pagesën e aplikimit dhe pagesat e rregullimit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A të rregullores dhe nuk rezulton debitore ndaj ERE-s për sa u përket pagesave të rregullimit.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga shoqëria “ECO-ELB” sh.a. rezulton i plotësuar si vijon:

- Neni 16 “Rinovimi i licencës”, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”. Plotësuar.

- ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin,

rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por ERE kushtëzohet nga afati i kontratës së qirasë për sa i përket afatit të vlefshmërisë që do të ketë ky rinovim licence, pra deri më datë 27.3.2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “ECO-ELB” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, me kapacitet të instaluar 2850 kw, me afat deri më datë 27.3.2024.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Maksim Shuli